**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec**

---

**01 Nr. 08/19**
**Rahovec, 22.08.2019**

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e cila do të mbahet më **30 Gusht 2019 ( E Premtë )** me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

## R E N D   D I T E

1. Shqyrtimi dhe Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozimit të Kryetarit të Komunës për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale,
5. Informatë mbi implementimin e Planit për investime në hapësirat e hapura publike në Komunën e Rahovecit,
6. Rishqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Rregullores Komunale për Transparencë Komunale 2019.

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Afrim Dina**

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/ 2008), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 10/2019), nenit 10, 39, 40, 46, 57 dhe nenit 94 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2019 merr këtë:

**DRAFT - VENDIM**
**Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër**

**1.** Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 01/363/19 i datës 09.08.2019 dhe merret vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

**2.** Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekur në pikën **1** të këtij vendimi, është në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur SKAJA, e evidentuar P.SH.E Kosovës KK Rahovec me sipërfaqe të përgjithshme prej 5587 $m^2$ (pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë metra katror) dhe në shfrytëzim jepet vetëm objekti në sipërfaqe prej 800 $m^2$ (tetëqind metra katrorë) i cili gjendet në parcelat kadastrale si më poshtë:

**2.1.** Parcela kadastrale sipas Certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01043-1, kullosë e klasës 3 me sipërfaqe prej 5016 $m^2$ (pesë mijë e gjashtëmbëdhjetë metra katrorë).

**2.2** Parcela kadastrale sipas Certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01057-2, kullosë e klasës 2 me sipërfaqe prej 571 $m^2$ (pesëqind e shtatëdhjetë e një metra katrorë).

**3.** Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën **1** dhe **2** të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe interes i përgjithshëm, të cilat do të lehtësojnë ushtirimin e veprimtarisë biznesore dhe dhënia e mundësisë qytetarëve për vetëpunësim.

**4.** Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme komunale, të cekur në pikën **1** dhe **2** të këtij vendimi është afatshkurtër në periudhën prej _____ vite.

**5.** Komuna e Rahovecit e ruan të drejtën kur do herë që sipas nevojës, për realizimin e interesave publike të Komunës të ndryshoj kontratën me përfituesin e pronës së dhënë në shfrytëzim.

6. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

7. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga **komisioni vlerësues i ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë** sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01. Nr.576 datë 28.02.2017 për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba.

8. Obligohen Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvilloj procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

9. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.

10. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.

11. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01-Nr-** _______
**Me datë:** _________

**Afrim Dina**

________________
**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

---

Nr. protokollit 01/363/19
Me datë: 09.08.2019
Rahovec, 2019

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58, shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/15 qershor 2008), nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), nenit 74 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

## PROPOZON

**1.** Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

**2.** Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekur në pikën **1** të këtij propozimi, janë në zonën kadastrale Xërxë në vendin e quajtur SKEJA, objekti i destinuar për zhvillimin e aktiviteteve biznesore, e evidentuar P.SH. E Kosovës KK Rahovec, me sipërfaqe të përgjithshme prej 5587 m$^2$ (pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë metra katror) dhe në shfrytëzim jepet vetëm objekti në sipërfaqe prej 800 m$^2$ (tetëqind metra katrorë) i cili gjendet në parcelat kadastrale si më poshtë:

**2.1.** Parcela kadastrale sipas Çertifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01043-1, kullosë e klasës 3 me sipërfaqe prej 5016 m$^2$ (pesëmijë e gjashtëmbëdhjetë metra katrorë).

**2.2.** Parcela kadastrale sipas Çertifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01057-2, kullosë e klasës 2 me sipërfaqe prej 571 m$^2$ (pesëqind e shtatëdhjetë e një metra katrorë).

**3.** Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën **1** dhe **2** të këtij propozimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, gjithsesi është edhe interes i përgjithshëm dhe zhvillimi i aktivitetit biznesor dhe tu jepet mundësi qytetarëve të vetëpunësohen ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.

4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi, është afatshkurtër në periudhën nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

5. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2, përcaktohet në përputhje me Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba komunale në baza mujore.

6. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim, do të rregullohen me kontratë të veçantë të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe përfituesit e marrjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme

7. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.

***Me propozim të njoftohen:***

1. ***Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,***
2. ***Sekretaria e Kuvendit, dhe***
3. ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510033-01043-1

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **08-2452/19** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 07.08.2019 - 14:18 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | Rahovec / Orahovac / Rahovec |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | XËRXË / ZRZE / XËRXË |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | Rahovec / Orahovac / Rahovec |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71510033-01043-1 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | 5016 | 6-1994 | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| SKEJA-/SKEJA-/SKEJA- | | SKEJA- | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS Komuna e Rahovecit Drejt. për Kadas.-Gjeod. dhe Pronë RAHOVEC / VIII ORAHOVAC / Odelj. za Katas.-Geod. i Imov. Opština Orahovac REPUBLIKA KOSOVA

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 3/Pasnjak 3 Klase/3rd Class Pasture | 5016 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | **P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVEC** | KCID1503883 | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC / | | RAHOVEC | **1/1** | 6-1994 | |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510033-01057-2

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 08-2452/19 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 07.08.2019 - 14:18 |
| Komuna / Opština / Municipality: | Rahovec / Orahovac / Rahovec |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | XËRXË / ZRZE / XËRXË |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | Rahovec / Orahovac / Rahovec |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71510033-01057-2 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | 571 | 6-1994 | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| SKEJA-/SKEJA-/SKEJA- | | SKEJA- | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS Komuna e Rahovecit Drejt. për Kadas.-Gjeod. dhe Pronë RAHOVEC / REPUBLIKA KOSOVA Opština Orahovac Odelj. za Katas.-Geod. i Imov. ORAHOVAC VIII

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person



Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Atip Kryeziu | P-71510033-01057-2 |

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 2/Pasnjak 2 Klase/2nd Class Pasture | 571 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhurnar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | **P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVEC** | KCID1503883 | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC / | | RAHOVEC | **1/1** | 6-1994 | |

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Xërxë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m2 |
|---|---|---|
| P-71510033-01043-1 | Parcelë / Parcela / Parcel | 5016,0 |
| P-71510033-01057-1 | | |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:905

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 07.08.2019

Koha/ Vreme/ Time: 02:26:49

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Izvorio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

# KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Xërxë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m2 |
|---|---|---|
| P-71510033-01043-1 | Parcelë / Parcela / Parcel | 5016,0 |
| P-71510033-01057-1 | | |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:905

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 07.08.2019

Koha/ Vreme/ Time: 02:26:49

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Odobrio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

**Drejtoria për Shërbime Publike**
Odeljenje za Opštinske Javne Usluge
Department of Municipal Public Services

| | |
|---|---|
| Datë/Datum/Date: | 08.08.2019 |
| Referenc-ë | |
| Për/Za/To: | Afrim Dina, Kryesues i Kuvendit Komunal të Rahovecit |
| CC: | Anëtarët e Kuvendit Komunal |
| Përmes/Preko/Through: | |
| Nga/Od/From: | z.Përparim Krasniqi, Drejtor për Shërbime Publike |
| Subjekti/Predmet/Subject: | Informatë |

**Informatë mbi implementimin e Planit për Investime në Hapësirat e Hapura Publike në Komunën e Rahovecit**

Komuna e Rahovecit ka planin 5 vjeçar të mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike 2016-2021 i miratuar në dhjetor të vitit 2016 nga ekspert të fushave të drejtorisë së shërbimeve publike si dhe me ndihmën e eksperteve të projektit DEMOS, ku edhe është mbështetur ky plan.

Komuna ka sipërfaqe prej 275,5 km 2, me 35 vendbanime dhe një qendër urbane, ku në të gjithë territorin e komunës sonë, janë përfshirë hapësirat për mirëmbajtje.

Zonat e përfshirjes se HHP-ve në këtë dokument përfshin;

1. Mirëmbajtjen e gjelbërimit, të ulët, të mesëm dhe të lartë,
2. Mirëmbajtjen e ambienteve të ndërtuara, sheshe, shtigje për këmbësorë dhe sipërfaqe të shtruara,
3. Mirëmbajtjen e hapësirave për parkim automjetesh
4. Mirëmbajtjen e ndriçimit publik në kuadër të HHP-ve, në kuadër të kësaj strategjie, mirëmbajtja e ndriçimit publik është kontratë e veçante nga kontrata për mirëmbajtjen e hapësirave publike.
5. Mirëmbajtjen e varrezave, lapidareve, pllakave përkujtimore, etj..

Të dhënat mbi sipërfaqet aktuale të HHP-ve në qytetin e Rahovecit janë këto:

- Parqe gjelbërime, 6944 m2
- Sheshe, 865m2
- Shëtitore pranë lumit, 3100 m2
- HHP-të pranë lapidareve, 44 m2
- HHP-të pranë pllakave përkujtimore, 4552 m2



**Drejtoria për Shërbime Publike**
**Adresa:** Xhelal Hajda – Toni p.n. Rahovec, Kosovë
**Tel:** +381 29 276 943
**http://kk.rks-gov.net/rahovec**

- Varreza të dëshmoreve, 7528 m2
- Varreza të martireve, 4750m2
- Varreza në zonën urbane, 99921.5 m2
- Varreza në zonën rurale, 147997 m2

Para se të fillon projekti i mirëmbajtjes së hapësirave publike kontratat e komunës së Rahovecit kane qenë të identifikuara në mase jo të duhura, mirëpo nga viti 2018 ka ndryshuar ky proces për të mirë, për shkak se edhe ka dal si rekomandim i eksperteve të fushave qe kjo të shpërndahet me shumë zona, në mënyrë që mirëmbajtja e hapësirave publike të jetë me e kompletuar dhe e rregullt.

Ne, duke e respektuar rekomandimet dhe planin e aprovuar, si komunë e Rahovecit kemi kontraktuar tre operator ekonomik që kanë kontratë me komunën e Rahovecit për mirëmbajtjen e hapësirave publike.

- **Lot 1- 16,709.28 euro, në 40 lokacione është paraparë mirëmbajtja,**
- **Lot 2- 21,359.06 euro, në 37 lokacione,**
- **Lot 3 -15,233.76 euro, në 26 lokacione,**
- Gjithsej 103 lokacione, duke përfshirë, varreza të dëshmorëve, lapidarëve, pllakave përkujtimore, sheshe, trotuare, rreth-rrotullime, hapësira të lira publike, etj...

Vlera e tyre në total për tre operatore ekonomik sillet në **53,302.16** euro.

<u>Synimet dhe objektivat specifike</u>

Në kuadër të HHP-ve një ndër synimet kryesore është edhe ngritja e nivelit të mirëmbajtjes dhe përmirësimi i cilësisë, nëpërmjet planit të hartuar, si;

- Sensibilizimi i komunitetit për mirëmbajtjen e hapësirave publike, si dhe
- Rigjallërimi i HHP-ve, duke rritur sipërfaqet publike me parqe, drunjtë dekorativ, hapësira të gjelbëra, investime në zonat e ndotura, rikthimi i atyre deponive ilegale në hapësira të gjelbëruara, mbjellja e drunjtëve dekorativ në rrugët kryesore dhe atyre lokale.

Tashmë kemi një rritje enorme nga viti në vit në kuadër të mirëmbajtjes së hapësirave publike, përveç investimit kemi rritje edhe në kosto financiare të mirëmbajtjes, derisa në vitin 2016 kemi pasur një vlerë prej 25,000.00 euro për mirëmbajtje ne vit, kjo në vitin 2019 është dyfishuar në vlerë prej 53,000.00 euro në kosto vjetore.

Me respekt,
**Përparim Krasniqi**
Drejtor i Shërbimeve Publike

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Nr. protokollit:01/358/19
Me datë: 07.08.2019
Rahovec

Në bazë të nenit 12 pika 1, nenit 17 shkronja (a) dhe nenit 40 pika 2 shkronja (a) dhe (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 12, nenit 39 , 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Propozimit të Kryetarit të Komunës me Nr.01/358/19 të dt.07.08.2019 Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.08.2019 miraton:

**Ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale me 01Nr.576 të dt.: 28.02.2017.**

1. Me këtë vendim **NDRYSHOHET DHE PLOTËSOHET** rregullorja për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale me 01Nr.576 të dt.: 28.02.2017, dhe atë:

2. Në **nenin 23** të rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale me 01Nr.576 të dt.: 28.02.2017 të plotësohet si në vijim :

**Neni 23**
**Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Turizëm**, Tabela sipas sektorëve dhe kodeve të ARBK -së :

| | | | Egzistues | Propozimet |
|---|---|---|---|---|
| **C2** | **1102** | **Prodhimi i verës nga rrushi** | **500.00 €** | **0.00€** |
| **G9** | **4711** | **Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani.** | **50,00€** | **0.00€** |
| **G10** | **4721** | **Tregtia me pakicë e frutave dhe perimeve në dyqanet e specializuara.** | **50,00€** | **0.00€** |
| **G12** | **4724** | **Tregtia me pakicë e bukës, ëmbëlsirave, produkteve prej mielli dhe produkteve prej sheqeri, në dyqanet të specializuara.** | **100,00€** | **0.00€** |
| **G15** | **4751** | **Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara** | **50.00€** | **0.00€** |
| **G20** | **4775** | **Tregtia me pakicë e artikujve kozmetike dhe të tualetit, në dyqanet e specializuara** | **50.00€** | **0.00€** |

3. Në **nenin 23** të rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale me 01Nr.576 të dt.: 28.02.2017, të plotësohet si vijon:
   - Tarifat komunale sipas sektorëve dhe kodeve të ARBK -së e përcaktuar në Nenin.23 të përcaktohen me vlerën - **0.00 € të lirohen nga taksat komunale.**

4. **Neni 17.5** i Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale me 01Nr.576 të dt. 28.02.2017, plotësohet si në vijim:

**17.5 Tarifat për sektorin e QPS –së :**

| Nr. | Emërtimi i shërbimeve | Lëvizja e shërbimit | Shumae pagesës | Propozimi i ri |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Për vërtetimin/konstatimin për humbjen e shtetësisë me lirim *(për pagesën e shërbimit, nuk përjashtohet asnjë kategori sociale).* | Ndryshohet | 5 | 20 EUR |
| 2 | Për vërtetim/konstatim (SNS) për fitimin e shtetësisë, *(në përjashtim të rastit social)* | Ndryshohet | 5 | 20 EUR |
| 3 | Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e veprimit (për armëmbajtje), *(për pagesën e shërbimit, nuk përjashtohet asnjë kategori sociale).* | Ndryshohet | 5 | 20 EUR |
| | Vërtetimi i zotësisë së veprimit për punësim fillestar. *(në përjashtim të rastit social).* | Plotësohet | 5 | 10 EUR |
| | Vërtetimin e zotësisë së veprimit për punësim (sigurim fizik, avokat, etj.) *(për pagesën e shërbimit, nuk përjashtohet asnjë kategori sociale).* | Plotësohet | 5 | 10 EUR |
| 4 | Pëlqim për martesë para moshës madhore, *(në përjashtim të rastit social).* | Ndryshohet | 5 | 10 EUR |
| 5 | Caktimi i emrit personal. | Të hiqet | 3 | 0 EUR |
| 6 | Kërkesë për regjistrim të mëvonshëm të fëmijëve | Të hiqet | 5 | 0 EUR |
| 7 | Pëlqim për përfaqësim në gjykatë për fëmijët për trashëgimi, nënshkrimi i kontratave të ndryshme. | Të hiqet | 3 | 0 EUR |
| 8 | Vërtetim që pala nuk është në përkujdesje e kujdestarit të përkohshëm ligjor | Të hiqet | 5 | 0 EUR |
| 9 | Pëlqim për udhëtim jashtë vendit për fëmijë, prindërit e të cilëve jetojnë ndaras jashtë shtetit. | Të hiqet | 5 | 0 EUR |
| 10 | Mendim për adoptim | Të hiqet | 5 | 0 EUR |
| 11 | Anamneza Sociale, (Konstatim i gjendjes faktike) | Ndryshohet | 3 | 10 EUR |
| 12 | Vërtetim që nuk është përfitues i ndihmës sociale | Ndryshohet | 3 | 5 EUR |
| 13 | Të gjitha shërbimet tjera, (lidhur me konstatimin i gjendjes faktike), për shfrytëzuesit që nuk janë raste sociale. | Plotësohet | 3 | 5 EUR |

5. **Neni 17.5** i rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale me 01Nr.576 të dt.: 28.02.2017 të plotësohet sipas tabelarit e lartcekur,

6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky **NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI** i Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***U dërgohet :***

- ***Kryesuesit dhe Anëtarëve të Kuvendit,***
- ***MAPL-së,***
- ***Sekretarisë së Kuvendit dhe***
- ***Arkivit.***

**Afrim Dina**

---

**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
**Kuvendi i Komunës Rahovec**
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

# DRAFT- RREGULLORE NR. 03/2019

# RREGULLORE KOMUNALE PËR TRANSPARENCË

**Rahovec, 2019**

Në bazë të nenit 11 dhe 12.2 shkronja c), nenit 17 shkronja i) dhe nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L–040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 28/2008"), Dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike i dt. 30.05.2019, Dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2018 për Transparencë në Komuna, Dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna dhe nenit 12 paragrafi 2 pika 2.1 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2019 miraton këtë:

# RREGULLORE KOMUNALE PËR TRANSPARENCË

## 1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Qëllimi

Më këtë Rregullore synohet që të arrihet:

**1.1** Forcimi i transparencës në punë të organeve të Komunës: Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës, organeve të Administratës: drejtorive komunale, institucioneve arsimore dhe shëndetësore, punës së ndërmarrjeve publike komunale dhe rritjes së pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivel lokal.

**1.2** Zbatimi i praktikave të mira administrative për qasje në dokumente.

### Neni 2
### Fushëveprimi

**2.1** Kjo Rregullore rregullon pjesëmarrjen e publikut në mbledhjen e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, obligimin për njoftim publik, konsultimet lidhur me aktet komunale dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në dokumentet zyrtare të Komunës.

### Neni 3
### Përkufizimet

Në hartimin e kësaj Rregulloreje janë përdorur përkufizimet e mëposhtme:

**3.1 "Mbledhjet e Kuvendit të Komunës"** - nënkupton mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të këshilltarëve të Kuvendit;

**3.2 "Komitetet"** - nënkupton trupa ndihmëse që i ndihmojnë Kuvendit në përmbushjen e përgjegjësive të caktuara me LVL dhe me Statutin e Komunës;

**3.3 "Pjesëmarrja e publikut"** - nënkupton pjesëmarrjen e qytetarëve në

vendimmarrje;

**3.4 "Njoftimi i publikut"** - nënkupton njoftimin e publikuar në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e Komunës, publikimin e njoftimeve në gazetat e përditshme dhe në internet për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, të komiteteve, të organeve administrative, të institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe ndërmarrjeve publike lokale;

**3.5 "Tubime publike"** - nënkupton tubimet e organizuara nga organet e Komunës, organet e Administratës – drejtoritë, institucionet dhe ndërmarrjet publike lokale, me qëllim të njoftimit për punën e bërë apo dhënien e propozimeve;

**3.6 "Peticioni"** - nënkupton kërkesën kolektive me shkrim që i adresohet Komunës, respektivisht Kryetarit të Komunës për çfarëdo çështje lidhur me përgjegjësitë dhe kompetencat e Komunës;

**3.7 "Konsultim publik i akteve komunale"** - nënkupton seancën dëgjimore dhe marrjen e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të publikut para miratimit të aktit;

**3.8 "Qasja në dokumentet zyrtare"**- nënkupton shikimin e dokumenteve zyrtare të Komunës, në pajtim me Ligjin për qasje në dokumente zyrtare.

## Neni 4
## Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

**4.1** Mbledhjet e Kuvendit të Komunës janë të hapura për publikun dhe për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.

**4.2** Kuvendi i Komunës njofton publikun për mbajtjen e mbledhjeve përmes Zyrës për marrëdhënie me publikun, të paktën 7 ditë pune para mbledhjeve të rregullta, ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme dhe mbledhje urgjente brenda dites.

**4.3** Njoftimi publik bëhet përmes:
- mediave të shkruara dhe elektronike dhe
- ueb-faqes së Komunës.

**4.4** Njoftimi me shkrim për publikun përmban: (i) datën e mbajtjes së mbledhjes, (ii) kohën e mbajtjes së mbledhjes, (iii) vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe (iv) rendin e ditës të caktuar për atë mbledhje.

**4.5** Mbledhjet e Kuvendit të Komunës mund të jenë të mbyllura pjesërisht ose tërësisht, vetëm për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Në këto raste, me vendim të arsyetuar, Kuvendi i Komunës i shpallë mbledhjet pjesërisht ose tërësisht të mbyllura për publikun.

**4.6** Aktet normative të komunës hyjnë në fuqi shtate (7) ditë pas publikimit të aktit në ueb faqen e komunës, përveç nëse me vete aktin nuk është përcaktuar ndryshe.
~~**Të gjitha rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasje në dokumentet zyrtare, duhet të bëhen publike tetë (8) ditë pas konfirmimit te ligjshmerise se tij.**~~

**4.7** Rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës publikohen në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

**4.8** Transmetimi në ueb-faqe të Komunës i seancave të Kuvendit të Komunës duke u

bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna.

## Neni 5
## Mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetet tjera

**5.1** Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe komitetet tjera janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.
**5.2** Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe komitetet tjera mund të jenë të mbyllura për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Vendimin për këtë e merr kryesuesi i mbledhjes.
**5.3** Zyra për Komunikim me Publikun njofton mjetet e informimit publik 7 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve. Njoftimi duhet të përmbajë: datën e mbajtjes së mbledhjes, kohën e mbajtjes së mbledhjes, vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe rendin e ditës të caktuar për atë mbledhje.

**5.4** Të gjitha propozimet e komiteteve, publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasje në dokumentet zyrtare, duhet të jenë në dispozicion për publikun sipas kërkesës.

## Neni 6
## Peticioni

**6.1** Secili qytetar dhe person juridik që ka interes në Komunë, ka të drejtë që, me vetiniciativë, përmes formës së peticionit, t'i propozojë Kuvendit të Komunës nxjerrjen e akteve juridike, me të cilat do të zgjidheshin çështjet e rëndësishme për qytetarët e komunës.
**6.2** Subjektet e përmendura më lart, mund t`i drejtojnë peticion Kuvendit të Komunës për çështjet që janë në kompetencën e tij, në mënyrë të pakufizuar, e që kanë të bëjnë me:
- **6.2.1** rregullimin e qytetit,
- **6.2.2** mirëmbajtjen e rendit dhe të infrastrukturës së komunës - qytetit,
- **6.2.3** urbanizimin e qytetit dhe të fshatit,
- **6.2.4** mirëmbajtjen e mjedisit jetësor,
- **6.2.5** zbatimin e vetëkontrollit dhe
- **6.2.6** çështje të tjera të rëndësishme për jetën e popullatës vendore.

**6.3** Një iniciativë e tillë e subjekteve fillon me nënshkrimin e tyre në formë të peticionit, me propozim të veçantë të çështjes së caktuar, dhe i drejtohet Kuvendit të Komunës përmes zyrës së drejtorit të Drejtorisë së Administratës.
**6.4** Kuvendi i Komunës mund të delegojë shqyrtimin e peticioneve të tilla në komitetet e përhershme.
**6.5** Kur një peticion nënshkruhet nga më shumë se 10% e qytetarëve të regjistruar në listën e votuesve, e që ka të bëjnë me çështjet që janë të lidhura me qytetin,

Kuvendi i Komunës duhet ta shqyrtojë çështjen. Për çështjet që kanë të bëjnë me fshatra apo lagje të caktuara, peticioni duhet të shqyrtohet nga Kuvendi i Komunës, nëse atë e nënshkruajnë së paku 10% e qytetarëve të regjistruar në listën e votuesve, banorë të atij fshati apo të asaj lagjeje.

**6.6** Nëse një fshat, vendbanim apo lagje, ka më pak se 4 500 banorë të regjistruar në listat e votuesve, peticioni do të jetë i vlefshëm nëse atë e nënshkruajnë 10% të banorëve të regjistruar në regjistrat e votuesve.

**6.7** Çdo peticion duhet të përmbajë emrin dhe adresën e parashtrues/it-ve, emrin dhe adresën e nënshkrues/it-ve, si dhe lëndën e peticionit. Lënda e peticionit duhet të ceket qartë në secilën faqe. Komunitetet mund t'i bëjnë peticione Kuvendit të Komunës përmes Komitetit të Komuniteteve. Përmbajtja e peticionit duhet të jetë ashtu siç është cekur më lart. Një peticion i cili nuk përmban elementet e duhura, nuk konsiderohet i vlefshëm.

**6.8** Drejtori i Drejtorisë së Administratës, në afat prej 30 ditësh nga dita që ai e pranon çdo peticion të vlefshëm, ia prezanton Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund t'ia referojë për shqyrtim të mëtejmë komitetit të caktuar. Përfaqësuesit e parashtruesve të peticionit e kanë të drejtën e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në mbledhje të komitetit dhe të Kuvendit të Komunës, me rastin e shqyrtimit të peticionit.

**6.9** Pas diskutimit në Kuvendin e Komunës Kryetari i Komunës ose shërbimi përkatës, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shqyrtimit njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit

~~**Vendimin përfundimtar për çështjen e peticionit e merr Kuvendi i Komunës, në afat prej 6 (gjashtë) javësh nga dita e prezantimit të peticionit në Kuvend. Vendimi do të arsyetohet me shkrim dhe do t'i komunikohet parashtrues/it-ve të peticionit.**~~

## Neni 7
## Takimet me publikun

**7.1** Komuna/Kryetari organizon takime publike periodike me qytetarë së paku 2 (dy) herë në vit.

**7.2** Në takimet me qytetarë, përfaqësuesit komunalë i informojnë pjesëmarrësit për çështjet që i përkasin interesit të përbashkët për zhvillimin e jetës dhe politikës komunale.

**7.3** Tubimet janë të karakterit të hapur dhe në to mund të marrin pjesë të gjithë të interesuarit.

**7.4** Tubimet publike janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.

**7.5** Pjesëmarrësit në këto tubime mund të marrin iniciativa, të japin propozime, sugjerime dhe të shprehin mendime për zgjidhjen e çështjeve të caktuara.

**7.6** Njëri tubim duhet të mbahet në gjashtëmujorin e parë të vitit, ndërsa tjetri në gjashtëmujorin e dytë.

**7.7** Nëse gjatë vitit mbahen vetëm dy takime me qytetarë, atëherë ndërmjet këtyre mbledhjeve duhet të ketë një interval kohor prej së paku tre muajsh.

**7.8** Tubimet e tilla mund të organizohen edhe nëpër fshatra, vendbanime dhe lagje të caktuara urbane.

7.9 Vendi, data dhe koha kur do të mbahen takimet me qytetarë shpallen në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e Komunës dhe në vendet më të frekuentuara në qytet, në fshatra dhe në lagje urbane, si dhe në ueb-faqen e Komunës dhe atë 14 ditë para mbajtjes së tubimit. Shpalljen publike e bën Zyra për Komunikim me publikun.

**7.10** Tubimet publike i udhëheq dhe i kryeson Kryetari i Komunës apo përfaqësuesi i tij.

**7.11** Kryetari është i autorizuar ta caktojë rendin e ditës dhe procedurën për udhëheqje të diskutimeve. Në rast nevoje, ka të drejtë t'i ndërpresë diskutimet për çështjet që nuk kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe pushtetin e Komunës. Ai mund t'i refuzojë, t'i thërrasë ose t'i dëgjojë diskutuesit të cilët prezantojnë ose përsërisin pikëpamjet dhe mund ta caktojë kohën e paraparë për diskutim.

**7.12** Nëse shtrohet ndonjë pyetje gjatë tubimit publik, për të cilën nuk mund të jepet përgjigje menjëherë, parashtruesi ka të drejtë të kërkojë përgjigje me shkrim brenda 30 ditësh pas mbajtjes së tubimit.

**7.13** Për çdo tubim publik mbahet procesverbali, i cili përmban të gjitha informatat e dhëna nga përfaqësuesit komunal, propozimet e parashtruara nga publiku dhe reagimin ndaj tyre, si dhe të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e dhëna.

**7.14** Obligim për publikimin e procesverbaleve në uebfaqe të komunës

**7.15** Procesverbalin me të gjitha çështjet e diskutuara dhe propozimet e dhëna, në afat prej 30 ditësh nga dita e mbajtjes së tubimit, e shqyrton Komiteti për Politikë dhe Financa. Komiteti analizon çdo propozim të parashtruar në tubim dhe bën rekomandimet e nevojshme, të cilat ia propozon Kuvendit të Komunës për tubimin e radhës.

## Neni 8
## Konsultimi publik i akteve komunale

**8.1** Rregulloret dhe dokumentet me interes te pergjithshem te Komunës i nënshtrohen diskutimit publik para se ato të miratohen. Organi përgjegjës që propozon dokumentin, cakton mënyrën e konsultimit me grupet e interesit, seancat dëgjimore për publikun dhe forma tjera të pjesëmarrjes së publikut.

**8.2** Zyra përgjegjëse për informim njofton publikun për pjesëmarrje të publikut për diskutim publik, përmes:

- **8.2.1** shpalljes publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës,
- **8.2.2** mediave të shkruar dhe
- **8.2.3** faqes së Komunës në internet.

**8.3** Njoftimi publik, sipas paragrafit të 8.2 të këtij neni, duhet të përmbajë datën e mbajtjes së mbledhjes, kohën e mbajtjes së mbledhjes, vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe rendin e ditës të paraparë për atë mbledhje.

**8.4** Organi kompetent që ka propozuar aktin, duhet të marrë pjesë aktivisht dhe të sqarojë përmbajtjen e aktit para publikut.

**8.5** Propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimeve, duhet të evidencohen. Propozimet shqyrtohen brenda 15 ditëve nga përfundimi i konsultimeve.

**8.6** Organi që ka propozuar aktin, duhet të informojë Kuvendin për propozimet e dhëna në diskutim publik, duke përfshirë propozimet e refuzuara, si dhe ato të marra

parasysh. Me rastin e miratimit të aktit, Kuvendi kujdeset që propozimet e argumentuara të përfshihen në tekstin përfundimtar të projektit.

**Neni 9**
**Caktimi i zyrtarit përgjegjës**

9.1 Përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është propozuesi i dokumentit të caktuar dhe njesia/zyrtari për komunikim me publikun.

**Neni 10**
**Parimet e konsultimit publik**

Komuna organizon konsultimet publike me qytetarë në përputhje me parimin e:

10.1 **Ligjshmërisë** - duke siguruar se procesi i konsultimit publik zhvillohet në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e përgjithshme të zbatueshme brenda kompetencave komunale;
10.2 **Transparencës** - që nënkupton një qasje e hapur e komunës për të garantuar se qytetarët dhe palët e interesuara janë të informuara dhe kanë qasje në të gjitha dokumentet në procesin e konsultimit publik dhe në gjuhët zyrtare;
10.3 **Barazisë dhe mosdiskriminimit** - në mënyrë që të gjitha palët e interesuara të kenë qasje të barabartë dhe jodiskriminuese në procesin e konsultimit publik;
10.4 **Efikasitetit në procesin e konsultimit publik** - duke mundësuar aplikimin e formave dhe teknikave më të përshtatshme për të kuptuar më lehtë përmbajtjen dhe ndikimin e pritur të projekt - propozimeve.

**Neni 11**
**Dokumentet për konsultim publik**

Komuna është e obliguar të ofroj konsultimin publik për të gjitha dokumentet e politikave lokale si në vijim:

11.1 Projekt-Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës / ekzekutivit;
11.2 Projekt-buxhetin e Komunës për vitin vijues, si dhe rishikimin buxhetor;
11.3 Korniza afatmesme buxhetore për 3 vitet e ardhshme;
11.4 Strategjitë zhvillimore dhe planet e veprimit në nivel lokal në kuader të fushave sektoriale;
11.5 Të gjitha projekt-planet hapësinore në nivel lokal, konform legjislacionit për planifikim hapësinor;
11.6 Te gjitha dokumentet e tjera për të cilat komuna vlerëson se janë të nevojshme të kalojnë në konsultim publik.

11.7 Çfarëdo dokumenti tjetër të paraparë në legjislacionin e zbatueshëm që duhet t'i nënshtrohet procesit të konsultimit publik.

**Neni 12**
**Format dhe teknikat e konsultimit publik**

Publikimet dalin edhe në Platformën për Konsultime Publike të Qeverisë të integruar si vegëza në ueb-faqen zyrtare të komunës.

**Neni 13**
**Planifikimi i konsultimeve publike**

**13.1** Planinfikimi i përgjithshëm konsultimeve publike bëhet që në fazën e hershme gjatë hartimit të planit të punës së komunës për vitin e ardhshëm kalendarik si dhe me rastin e hartimit të planit për komunikim publik.
**13.2** Forma dhe teknika tjera te konsultimit publik (takimet publike, konferenca, stendat ne rruge, konsultim me shkrim (online) si dhe format dhe tehnikat tjera te caktuara me UA per standardet minimale të konsultimit publik ne Komuna.

**Neni 14**
**Zbatimi i standardeve të konsultimit publik**

**14.1** Komuna bën publikimin e projekt-propozimeve në ueb-faqet zyrtare të komunave dhe në Platformën e Konsultimeve Publike në nivel Qendror.
**14.2** Projekt-propozimet të cilat i nënshtrohen konsultimit publik duhet të jenë të qarta dhe të kompletuara me të gjitha dokumentet përcjellëse.
**14.3** Komuna për politikat e caktuara të parapara në legjislacionin në fuqi, duhet të siguroj konsultimin në fazat e hershme të hartimit, palët e interesuara që ndikohen apo janë të interesuara të ndikojnë drejtëperdrejtë në procesin e vendimmarrjes.
**14.4** Komuna është e obliguar të shpall rezultatet e procesit të konsultimit publik, të publikoj raportin me të gjitha propozimet e ofruara nga qytetarët, si dhe të jap sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve të tjera të interesuara.

**Neni 15**
**Aktet nënligjore të Komunës për konsultim publik**

Aktet e Komunës që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik janë:
**15.1** Draft-Statuti i Komunës;
**15.2** Projekt-Rregulloret Komunale;
**15.3** Aktet tjera që parashihen me ligjet sektoriale;

**Neni 16**
**Mbikëqyrja e procesit të konsultimit publik**

**16.1** Kryetari i Komunës siguron që projekt-propozimet e dorëzuara për aprovim në Kuvendin e Komunës i permbushin standardet minimale për procesin e konsultimit publik.
**16.2** Kuvendi i Komunës refuzon aprovimin e projekt-propozimeve në rastet kur nuk janë përmbushur standardet minimale të konsultimit publik sipas kritereve të percaktuara në këtë udhëzim administrativ.

**Neni 17**
**Koordinimi, bashkëpunimi dhe raportimi**

**17.1** Komuna obligohet të koordinohet me MAPL dhe me Zyrën për Qeverisje të Mire / Zyra e Kryeministrit dhe për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunal per konsultim publik.

**Neni 18**
**Transparenca e vendimeve të organeve të Komunës**

**18.1** Aktet normative të komunës hyjnë në fuqi shtate (7) ditë pas publikimit të aktit në ueb faqen e komunës, përveç nëse me vete aktin nuk është përcaktuar ndryshe.
~~**Publikimi në faqen zyrtare të Komunës i akteve normative të Komunës me karakter të përgjithshëm është i obligueshëm në afat prej 7 ditë pune nga konfirmimi i ligjshmërisë së vendimit.**~~
**18.2** Në ditën në të cilën akti normativ i komunës publikohet në ueb faqe të komunës do të përcaktohet si dita e shpalljes.
~~**Të gjitha vendimet e Kryetarit të Komunës pas nënshkrimit dhe pas konfirmimit të ligjshmërisë publikohen në faqen zyrtare të Komunës.**~~
**18.3** Aktet normative dhe vendimet e organeve të Komunës dërgohen në njësinë përgjegjëse për publikim në faqen zyrtare të Komunës në formën elektronike, në gjuhët zyrtare dhe në formatin e përcaktuar nga njësia/zyrtari përgjegjës për publikim të aktit normativ dhe vendimet e organeve të Komunës.

**Neni 19**
**Transparenca financiare**

**19.1** Komuna obligohet në transparencë të planifikimeve dhe shpenzimeve buxhetore duke ndërmarrë veprime konkrete në publikimin e tyre në faqen zyrtare të Komunës.
**19.2** Plani i buxhetit pas aprovimit në Kuvendin e Komunës dhe vlerësimin e ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës.
**19.3** Raportet tre mujore financiare sipas afateve të parashikuara me legjislacion sektorial.
**19.4** Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) pas aprovimit në Kuvendin e Komunës dhe vlerësimin e ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës.
**19.5** Raporti përmbledhës financiar për vitin e kaluar fiskal sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin sektorial.

19.6 Publikimi i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

**Neni 20**
**Transparenca në aktivitetet e prokurimit**

**20.1** Komuna publikon në faqen zyrtare elektronike çdo aktivitet të prokurimit, publikimi i të cilave është i përcaktuar me legjislacionin sektorial.
**20.2** Komuna publikon planin dhe raportin e prokurimit në faqen zyrtare elektronike, ashtu siç përcaktohet me legjislacionin sektorial.

**Neni 21**

**Qasja e drejtpërdrejtë në informata dhe dokumente publike**

Komuna siguron qasje në informata dhe dokumente publike përmes faqes zyrtare të saj, si:

**21.1** Planin e punës së Kryetarit dhe Kuvendit të Komunës.
**21.2** Planin për Konsultim Publik.
**21.3** Planin për Komunikim Publik.
**21.4** Strategjitë dhe dokumentet e tjera të politikave të miratuara.
**21.5** Planin Zhvillimor Komunal, Hartat zonale dhe planet rregulluese urbane.
**21.6** Raportin vjetor të punës së Kryetarit dhe Kuvendit.
**21.7** Procesverbalet e takimit të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve obligative.
**21.8** Të dhënat për biografitë e udhëheqësve të lartë të organeve të komunës dhe anëtarëve të Kuvendit Komunal.
**21.9** Emrin, numrin e telefonit zyrtar dhe adresën e e-mail-it të drejtuesve të njësive brenda institucionit.
**21.10** Listën e hollësishme të shërbimeve që ofron institucioni për publikun, si: licenca, leje, autorizime, certifikata, vërtetime apo shërbime publike të tjera, ku do të përfshihen edhe:
**21.11** Procedurat dhe kushtet e përfitimit të tyre.
**21.12** Afati i detyrueshëm për të marrë përgjigje për shërbimin e kërkuar.

**Neni 22**
**Hartimi i Planeve Vjetore të Punës në Komuna**

**22.1** Komunat obligohen që të hartojnë Planet Vjetore të Punës së Kryetarit të Komunës dhe të Kuvendit.
**22.2** Në përputhje me pikën 1 të këtij Neni Komunat obligohen të hartojnë Planin për Komunikim me Publik dhe Planin për Konsultim me Publikun.

**Neni 23**
**Format e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje**

**23.1** Komuna siguron mekanizma të përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse në çdo fazë të procesit të hartimit dhe zbatimit të politikave lokale, duke filluar nga:

23.1.1 Planifikimi;
23.1.2 Diskutimi;
23.1.3 Marrja e vendimit;
23.1.4 Implementimi dhe
23.1.5 Monitorimi.

23.2 Mekanizmat e lartpërmendura duhet të shfrytëzohen me qëllim të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, si:
23.2.1 Informimi me kohë dhe komunikimi, përmes së cilëve qytetarët do të mund të shprehnin sugjerimet, kërkesat dhe vërejtjet e tyre;
23.2.2 Përfshirjen e qytetarëve në grupet punues;
23.2.3 Organizimi i takimeve periodike me qytetarë në fshatra dhe lagje;
23.2.4Themelimi i Komiteteve konsultative për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, në veçanti për planifikimin hapësinor dhe buxhetin;
23.2.5 Fuqizimi i bashkëpunimit në mes të Komunës dhe shoqërisë civile.

23.3 Duke promovuar qeverisje të mirë, komunat inkurajojnë personat me nevoja të veçanta të moshuarit, minoritetet, të rinjtë, gratë në procesin e vendimmarrjes duke gjetur forma dhe mekanizma shtesë.

## Neni 24
## Plani i veprimit për transparencë në Komuna

24.1 Komunat obligohen të hartojnë planin katër (4) vjeçar të veprimit për transparencë në komunë, dhe pas miratimit në kuvendin e komunës, i njëjti publikohet në faqen zyrtare të komunës.
24.2 Plani i veprimit për transparencë në komuna ka për synim t'i ofrojë publikut qasje në monitorim dhe zbatim të akteve të komunës, duke përfshirë edhe menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive, prokurimit dhe sferave tjera të cilat janë në interes për publikun.
24.3 Plani duhet të përfshijë:
24.3.1 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës;
24.3.2 Mbledhjet e Komiteteve;
24.3.3Takimet publike;
24.3.4 Takimet konsultative;
24.3.5 Takimet obligative në media për çështje që lidhen me shfrytëzimin e buxhetit të komunës;

24.3.6 Shpalljet publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit administrativ të komunës;
24.3.7 Takimet me grupet e interesit për të diskutuar çështje të sigurisë në bashkësi;
24.3.8 Qasje të shpejtë dhe transparente të shërbimeve për qytetarët;
24.3.9 Procedurat transparente të Prokurimit;
24.3.10 Procedurat transparente të punësimit;
24.3.11 Publikimin e aktiviteteve ditore në faqe zyrtare;
24.3.12 Përfshirja aktive e qytetarëve në vendimmarrje.

## Neni 25
## Gjuhët për komunikim zyrtar

**25.1** Pjesëtarët e komunitetit pakicë kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhët e tyre, në të gjitha organet e Komunës dhe me të gjithë nëpunësit civilë të Komunës. Anëtarët e Kuvendit të Komunës kanë të drejtë të shprehen në gjuhët e tyre në mbledhjet e Kuvendit dhe në organet e tij.

**25.2** Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të komiteteve, të Këshillit të Drejtorëve dhe në të gjitha tubimet publike, diskutimet mund të bëhen në të dy gjuhët, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

**25.3** Aktet normative të Komunës shtypen në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Të gjitha dokumentet zyrtare të lëshuara nga organet e administratës, jepen në gjuhën e palës. Gjuhë e palës konsiderohet gjuha në të cilën pala fillimisht i drejtohet Komunës.

**25.4** Rregulloret komunale dhe vendimet mund të shtypen edhe në gjuhën e një komuniteti tjetër, nëse ai komunitet e kërkon atë.

**25.5** Shenjat zyrtare që tregojnë emrat e fshatrave, të vendbanimeve, të rrugëve dhe të vendeve tjera publike, janë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

**25.6** Komunikimi me institucionet komunale, institucionet e Republikës së Kosovës dhe organet e organizatat tjera, mund të bëhet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Gjuha turke dhe gjuha boshnjake mund të përdoren në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

**25.7** Çështjen e përdorimit të gjuhëve, Kuvendi i Komunës do ta rregullojë me rregullore për gjuhët.

## Neni 26
## E drejta e publikut për qasje në dokumente zyrtare të Komunës

**26.1** Secili person fizik apo juridik ka të drejtë në qasje të dokumenteve të organeve komunale, duke ju nënshtruar Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Statutit të Komunës së Rahovecit.

**26.2** Kjo Rregullore vlen për të gjitha dokumentet që mbahen nga organet kompetente të Komunës, të hartuara apo të pranuara nga këto organe, për të gjitha fushat dha aktivitetet e Komunës, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.

**26.3** Personat fizikë dhe ata juridikë, nga paragrafi 2 i këtij neni, e gëzojnë të drejtën të jenë të informuar për politikat, vendimet dhe punën e organeve të Administratës komunale.

## Neni 27
## Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare

**27.1** Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare parashtrohet në formë të shkruar, në formë elektronike ose verbalisht, duke u përshkruar informacioni që kërkohet, në mënyrë që Komuna ta identifikojë dokumentin. Parashtruesi nuk është i detyruar t'i japë arsyet për parashtrimin e kërkesës.

**27.2** Nëse kërkesa bëhet verbalisht, zyrtari përgjegjës për qasje në dokumente publike obligohet të hartojë kërkesën me shkrim për procedim të mëtejmë. Nëse kërkesa bëhet në formë elektronike, atëherë ajo konsiderohet si kërkesë me shkrim.

**27.3** Nëse kërkesa nuk është e saktë lidhur më informacionin që kërkohet, organi kërkon nga parashtruesi që të qartësojë kërkesën dhe mund ti ndihmojë kërkuesit që të bëjë një gjë të tillë.

**27.4** Organet kompetente komunale e kanë për obligim që, që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japë përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesërishëm dhe informon kërkuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkese për rishqyrtim. Refuzimi i kërkesës bëhet me aktvendim me shkrim për refuzim të saj.

**27.5** Në rast të refuzimit të plotë apo të pjesërishëm, kërkuesi mundet, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas marrjes së përgjigjes nga institucioni publik, të parashtrojë kërkesën për rishqyrtim e çështjes duke kërkuar nga institucioni që të rishqyrtojë vendimin.

**27.6** Afatet për realizimin e të drejtës për qasje në informatë, respektivisht në dokumente publike, të përcaktuara me këtë ligj, mund të vazhdohen më së shumti deri pesëmbëdhjetë (15) ditë, në qoftë se:

**27.5.1** dokumenti duhet të kërkohet brenda një numri të madh të dokumenteve apo jashtë institucionit publik;

**27.5.2** me një kërkesë kërkohen një numër i madh i dokumenteve nga e njëjta palë.

**27.6** Përkitazi me vazhdimin e afatit, institucioni publik ose sektori i tij, pa vonesë e më së voni brenda afatit prej tetë (8) ditësh të tjera pune, do ta njoftojë kërkuesin me ecurinë dhe arsyet që kanë shkaktuar shtyrjen e afatit.

**27.7** Nëse organet komunale nuk përgjigjen brenda afatit kohor të përcaktuar, parashtruesi ka të drejtë ta ushtrojë kërkesën konfirmuese. Në rast se kërkesa konfirmuse refuzohet plotësisht apo pjesërisht, organi komunal kompetent e njofton parashtruesin me mjete ligjore që i ka në dispozicion ai/ajo (nisja e procedurës gjyqësore ose parashtrimin e ankesës Avokatit të Popullit).

## 2. DISPOZITAT KALIMTARE

**Neni 28**
**Zbatimi i Rregullores**

**28.1** Për zbatimin e kësaj Rregulloreje përgjegjës është Kuvendi i Komunës, Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë Komunale.

**Neni 29**
**Hyrja në fuqi**

**29.1** Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Transparencë 01 Nr. 907 e datës 30.03.2016.
**29.2** Çdo dispozit e kësaj Rregullore që bie në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, përparësi do të kenë dispozitat e ligjit në fuqi.
**29.3** Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës.

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01-Nr.** ________
**Datë:** ___________

**Afrim Dina**
______________
**Kryesues i Kuvendit**

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale Nr.. 03/L-040, Ligjit për financat e pushtetit lokal Nr..03/L-049, si dhe nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 569/1 të dt.16.12.2010, dhe rekomandimit të komisionit të përbashkët MEF-MAPL dhe MMPH, për vlerësimin e ligjshmërisë së Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale, 01. Nr .576 e dt. 28. 02. 2017. Kuvendi i Komunës Komunës së Rahovecit aprovoi këtë:

# R R E G U LL O RE

# PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1

### Qëllimi

**1.1 Me Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba përcaktohen:**

- Fusha e caktimit të taksave, tarifave, ngarkesave dhe gjobave komunale si dhe obliguesit
- Llojet dhe lartësia e taksave, tarifave, ngarkesave dhe gjobave
- Obliguesit e komunës për mbledhjen e taksave nga nxjerrja (shfrytëzimi) i pasurive natyrore
- Detyrat dhe përgjegjësitë për zbatimin e Rregullores
- Procedura dhe masat për mos përmbushjen e obligimeve dhe
- Procedura e ankesave në aktet mbi përcaktimin e obligimeve të pagesave

**1.2** Taksat, tarifat, ngarkesat dhe gjobat janë të hyra buxhetore të komunës të arkëtuara nga obliguesit të përcaktuara me këtë rregullore dhe aplikohen për territorin e komunës se Rahovecit.

## II APLIKIMI I TAKSAVE, TARIFAVE, NGARKESAVE, GJOBAVE DHE OBLIGUESIT

### Neni 2

2.1 Taksat, tarifat, ngarkesat dhe gjobat që aplikojnë organet ndaj personave fizik-qytetarëve dhe personave juridik në emër të kompensimit të punës, shërbimeve komunale dhe marrjen e vërtetimeve, dokumenteve zyrtare (janë të hyra në buxhetin e komunës që arkëtohen nga detyruesit e caktuar me këtë rregullore do zbatohen në tërë territorin e komunës së Rahovecit) dhe përfshijnë:

- Lëshimi i dokumenteve zyrtare,
- Dhënia e pëlqimeve të punës,
- Dhënia lejeve në lëmin e ndërtimeve, përdorimit dhe prishjes së objekteve
- Shëndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore dhe dhënia me qira e tokës bujqësore
- Rregullimi i tokës ndërtimore
- Dhënia më qira e pronës dhe ndërtesave të komunës

- Dhënia në shfrytëzim të objekteve (hapësirave) dhe teknikës komunale të destinuara për manifestime, aktivitete kulturore dhe sportive etj.
- Shërbimet gjeodezike dhe kadastrale
- Regjistrimi i të drejtave të pronësisë, posedimit, hipotekave, servituteve, qiramarrjes dhe përçueseve
- Regjistrimi i pronësisë së automjeteve motorike
- Parkingu dhe rimorkimi i automjeteve
- Shërbimet në shëndetësi, arsim dhe inspektimet
- Ushtrimi i veprimtarisë afariste dhe lejeve për punë profesionale
- Shfrytëzimi i burimeve natyrore
- Gjobat nga trafiku dhe gjobat për shkeljen e rregullave komunale.

**Neni 3**

**3.1** Obliguesit në kuptim të kësaj rregulloreje janë personat fizik-qytetarët dhe personat juridik, si parashtrues të kërkesave për shfrytëzimin e shërbimeve komunale, pajisjen me dokumente zyrtare, përkatësisht lejeve, vërtetimeve, pëlqimeve si dhe kryerjen e detyrimeve ndaj komunës

**Neni 4**

**Tarifat e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit**
**Taksa për shërbime komunale**

***Taksa për lëshimin e lejeve për ndërtim, përdorim, prishje të objekteve ndërtimore***

| Nr | Emertimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Leja për prishjen e objektit | 5,00 € |
| 2 | Vendim për vazhdimin e lejes së ndërtimit | 10.00 € |
| 3 | Leja për shfrytëzimin e tokës ndërtimore (vendosja e objekteve të përkohshme | 10.00 € |
| 4 | Miratimi i aktvendimeve, kopjet e vendimeve dhe pëlqimeve | 5.00 € |

**4.1.Tarifa të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit**

Për tu pajisur me Leje Mjedisore Komunale, aplikuesi duhet të paguaj tarifën prej 0.2% të vlerës investuese të projektit.

**SHTOJCA**

**Listës se aktiviteteve që i nënshtrohen Lejes Mjedisore Komunale**

1. Autoserviset.
2. Autolarjet.
3. Stacionet e karburanteve të benzinës me kapacitet 50$m^3$.
4. Pikë shitjet e gazit (GLN) deri në 5$m^3$.
5. Sharrë për lëndë drunore.
6. Fabrikë për përpunimin e drurit, mobilieri, etj, deri në 1000$m^3$/vit.
7. Fabrika për përpunim dhe ambalazhim të ujit natyral, me kapacitet deri në 1$m^3$/ditë.
8. Fabrika për prodhimin e lëngjeve frutash, pije freskuese, pije alkoolike, me kapacitet deri në 1$m^3$/ditë.
9. Furra për prodhimin e bukës dhe produkteve tjera nga mielli.
10. Rrjeti i kanalizimit të ujërave të zeza dhe rehabilitimi i tij në gjatësi deri në 5km.
11. Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit ekzistues, në gjatësi deri në 5km.
12. Riparimi i rrugëve ekzistuese dhe ndërtimi i akseve të reja rrugore (me gjatësi deri në 2km)
13. Fabrika për përpunim të qumështit dhe produkteve të tije, deri 1000 l/ditë.
14. Fabrika për prodhimin e vajrave bimore, etj. Me kapacitet 500kg/ditë.
15. Thertore me kapacitet deri 3 gjedha/ditë.
16. Fabrika për përpunim të pemëve dhe perimeve me kapacitet, deri në 1000kg/ditë.
17. Prodhim i gëlqeres (shuarja) deri 100ton/vit.
18. Prodhim i betonit dhe elementeve parafabrikate, pllakave etj. Me kapacitet deri në 50$m^3$/ditë.
19. Magazina e lubrifikantëve të ambalazhuar në vende prodhim.
20. Qendra për grumbullimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolomi, për Komunat të cilat kanë më pak se 60000 banorë.
21. Prodhimi i këpucëve dhe aksesorëve të tjerë të ngjajshëm, pa proces kimik(qepje, ngjitje, montim etje.
22. Prodhimi i kartonit dhe ambalazheve të tjerë, me kapacitet deri në 500kg/ditë.
23. Rritja artificiale e peshkut në hurdha, me sipërfaqe deri në 300$m^2$.
24. Punishtet e vogla për përpunim të mermerit, me sipërfaqe totale- objekti deri në 200$m^2$.
25. Ndërtimi i objekteve të banimit kolektiv dhe të shërbimeve (hoteliere, tregtare, komerciale, afariste, etj.) me sipërfaqe bazë ndërtimi më të madhe se 600$m^2$.
26. Veprimtaria e prodhimit të kompostit, me sasi totale përpunimi deri në 100$m^3$ ose 40 ton/vit.
27. Depoja për plehra kimik dhe pesticide, me kapacitet magazinues deri në 10 ton.
28. Objektet shërbyese për ushqime të shpejta.

29. Vendet ku deponohen, më pak se 10 ton mbeturinë inerte.

30. Impiantet për riciklimin dhe prodhimin e plastikes, me kapacitet deri 100 ton/vit.

31. Impiantet për rritjen intensive të shpezëve, derrave, bagëtive të imta dhe të mëdha që kanë më pak se: 3000 shpend; 150 derra; 30 gjedha; 300 bagëti të imëta.

32. Pajisjet për shfrytëzimin e fuqisë së erës për prodhim të energjisë, me fuqi instaluese deri në 100KW/h.

33. Sistemi solar dhe sistemet fotovoltaike të prodhimit të energjisë/avullit, deri në 100KW/orë

## Neni 5

## Taksat për rregullimin e tokës ndërtimore

5.1. *Lartësia e tarifës për rregullimin e tokës ndërtimore përcaktohet në bazë të tabela rit të shpenzimeve të Drejtorisë se Urbanizmit ,Planifikimit dhe Mbrojtjes se Mjedisit ne pajtim me ligjin për ndërtim Nr.04/L-110dhe U.A NR.22/2012 sipas të cilës përcaktohet lartësia e kompensimit të sip bruto në 1m².*

| Nr | Emertimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Ndërtimi i objekteve individuale banesore | 1,70 € m2 |
| 2 | Ndërtimi i objekteve banesore kolektive mbi tre banesa | 70 % prej vlerës 1,70 |
| 3 | Ndërtimi i objekteve industriale-afarizëm | 1,70 € |
| 4 | Ndërtimi i objekteve për administratë – zyra | 1,70 € |
| 5 | Ndërtimi i objekteve në formë të magazinave (depo, siloseve) për deponim për afarizëm | 1,70 € |
| 6 | Ndërtimi i bodrumit<br>Ndërtimi i nënkulmit,për banim | 40 % të vlerës<br>60 % të vlerës |
| 7 | Për objektet që rindërtohen në themelet e mëparshme (ekzistuese) dhe me sipërfaqe të njëjta | 40 % të vlerës |
| 8 | Hapësirat e lira të shfrytëzuara | 20 % të vlerës |
| 9 | Hapësirat e mbuluara të shfrytëzuara | 40 % të vlerës |
| 10 | Ballkonet, terrasat, llozhat | 40 % të vlerës |

## Neni 6

## Tarifa në sferën e shërbimeve publike.

## DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE KOMUNALE

## Taksat për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike për kryerjen e veprimtarisë së tyre, subjektet afariste të regjistruara

| Nr. | Emërtimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Teksat e vendosura para dyqanit. Tarifë ditore | 0.10 €/m² |
| 2 | Aparatet për pomfrit dhe të ngjashme, të vendosura jashtë lokalit. Tarifë ditore | 0,10 €/m² |
| 3 | Aparatet për akullore dhe ruajtjen e tyre të vendosura jashtë lokaleve. Tarifë ditore | 0,10 €/m² |
| 4 | Auto - dyqani lëvizës (dyqani mobil) Tarifë ditore | 1,00 €/m² |
| 5 | Dhënia e tokës me qira për kampingje, për vendosjen e lojërave të ndryshme, Luna Park etj. Tarifë ditore | 0,20 €/m² |
| 6 | Ekspozimi i mallrave para lokaleve afariste, në sipërfaqen e hapur publike, në të cilat nuk pengohet lëvizja e lirë e këmbësorëve, për së paku 3(tre ) muaj. Tarifë mujore | 2.00 €/m² |
| 7 | Vendosja e tavolinave para lokaleve hoteliere afariste në sipërfaqen e hapur publike deri ne 20 m², në të cilat nuk pengohet lëvizja e lirë e këmbësorëve për shfrytëzim se paku 3(tre) muaj.Tarifë mujore | 2.50 €/m² |
| 8 | Vendosja e tavolinave para lokaleve hoteliere afariste në sipërfaqen e hapur publike mbi 20 m², në të cilët nuk pengohet lëvizja e lirë e këmbësorëve për shfrytëzim së paku 3(tre) muaj .Tarifë mujore. | 2.00 €/m² |
| 9 | Vendosja e stendave lëvizëse promovuese në sipërfaqet e lira publike. Tarifë ditore | 10.0 €/m² |
| 10 | Vendosja e tendave lëvizëse në sipërfaqet e lira publike jashtë zonave të banimit .Tarifë ditore | **0.50 € /m²** |
| 11 | Vendosja e tendave promovuese në sipërfaqet e lira publike.Tarifë ditore. | **5.00 €/m²** |

**Propozimi i taksave për dëmtimin e rrugëve**

| Nr | Emërtimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Taksat për gërmimin – dëmtimin e rrugëve me asfalt, 0 - 10 m² | 90,00 € |
| 2 | Taksat për gërmimin – dëmtimin e rrugëve me asfalt > 10 - 20 m² | 70,00 € |
| 3 | Taksat për gërmimin – dëmtimin e rrugëve me asfalt > 20 - 50 m² | 60,00 € |
| 4 | Taksat për gërmimin – dëmtimin e rrugëve e me asfalt, mbi 50 m² | 50,00 € |
| 5 | Taksat për gërmimin – dëmtimin e rrugëve me kubëza, 0 - 10 m² | 40,00 € |
| 6 | Taksat për gërmimin – dëmtimin e rrugëve me kubëza > 10 - 50 m² | 60,00 € |
| 7 | Taksat për gërmimin – dëmtimin e rrugëve me kubëza, mbi 50 m² | 100,00 € |
| 8 | Taksat për gërmimin – dëmtimet e rrugëve me makadam - zhavor, deri 50 m² | 3,00 €/m² |
| 9 | Taksat për gërmimin – dëmtimet e rrugëve me makadam - zhavorr, mbi 50 m². | 2,00 €/m² |
| 10 | Tarifa për lëshimin i vërtetimeve dhe kopjeve të vërtetuara. | 5,00 € |

| | | |
|---|---|---|
| 11 | Leja për shfrytëzim të tokës ndërtimore (vendosja e objekteve të përkohshme) | 10,00 € |
| 12 | Leja për vazhdimin e kontratave | 5,00 € |
| 13 | Leje për gërmime | 10,00 € |
| 14 | Kontrata mbi kompensimin e shfrytëzimit të tokës ndërtimore | 10,00€ |

**Neni 7**

**Taksa për vendosjen e objekteve të përkohshme (Baraka, kiosqe,etj).**

| Nr | Emertimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Vendosja e objekteve me karakter të përkohshëm dhe për objekte tjera montuese (kioske) për rajonin e ngushtë të qytetit të Rahovecit. Taksë vjetore | 10,00 €/m² |
| 2 | Vendosja e objekteve me karakter të përkohshëm dhe për objekte tjera montuese (kioske) jashtë rajonit të ngushtë ndërtimor të qytetit te Rahovecit dhe në ato rurale. Taksë vjetore | 8,00 €/m² |
| 3 | Dhënia në shfrytëzim të hapësirës publike për objekte të përkohshme me material të fort, për nevoja jo ekonomike (garazhe, etj) deri në 18 m². Taksë vjetore | 80,00 € |
| 4 | Dhënia në shfrytëzim të hapësirës publike për objektet e përkohshme, për nevoja jo ekonomike (garazhe etj.) të karakterit montues – demontues. deri në 18 m². Taksë vjetore | 60,00 € |

**Neni 8**

**Taksa për dhënia me qira të hapësirës publike dhe aseteve nëntokësore për shfrytëzimin komercial paguhet**

| Nr | Emertimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Vendosja e transparentëve reklamuese. Taksë mujore | 15,00 €/m² |
| 2 | Vendosja e shpalljeve dhe publikimeve të përkohshme, në muret dhe objektet tjera. Taksë vjetore | 25,00 €/m² |
| 3 | Vendosja e reklamave të ndryshme afariste në hapësirën tokësore me sipërfaqe deri në 4 m². Taksë vjetore | 150,00 € |
| 4 | Vendosja e reklamave të ndryshme afariste –panove reklamuese( Bilboard dhe Citylight) me sipërfaqe më të madhe se 2.4 m² dhe më të vogël se 12 m². Taksë vjetore | 75,0 €/copë |
| 5 | Vendosja e reklamave të ndryshme afariste - panove reklamuese(Bilboard dhe Citylight) me sipërfaqe 12 m² apo më të madhe. Taksë vjetore | 200 €/copë |
| 6 | Vendosja e antenave PTK, IPKO, Kujtesa , RTK, KTV, RTV21 etj, në siperfaqet e lira publike deri në 100 m².Taksë vjetore | 1000€/antenë |
| 7 | Për rastet kur kontraktuesit e antenave PTK, IPKO, Kujtesa, RTK, KTV, RTV21, etj kërkojnë shfrytëzim të hapësirës publike mbi 100 m² (pranë vendit ku vendosen antenat) paguhet, *Taksë vjetore.* | 0.10 €/m² |

| | | |
|---|---|---|
| 8 | Vendosja e objekteve MDF-kutia(trafo,njehsore etj.) në sipërfaqe publike. *Taksë vjetore.* | 150.0 €/m² |
| 9 | Dhënia me qira të aseteve nëntokësore(gypat për vendosjen e kabllove). *Taksë vjetore* | 0.20 €/m |
| 10 | Leja e punës për auto– taxi. Taksë vjetore | 35,00 € |
| 11 | Vazhdimi i lejes për auto – taxi. Taksë vjetore | 30,00 € |
| 12 | Leja e punës për kombibus-taxi Taksë vjetore | 50.00 € |
| 13 | Vazhdimi i lejes për Kombibus-taxi. Taksë vjetore | 45.00 € |

**8.1 Taksat dhe tarifat nuk aplikohen në këto raste:**
- për sipërfaqet ku bëhet deponimi i mbeturinave
- për varrezat
- për sipërfaqet e gjelbërimit publik

**8.2 Tarifa dhe Tarifat nuk aplikohen për :**
-Objekte të banimit individual të shkatërruara nga lufta e të ndërtuara nga donacionet
-Objektet arsimore,kulturore,sportive,shëndetësore, si dhe qendrat rekreative që ndërtohen me mjete buxhetore, me investime të komunitetit, apo me donacione dhe që janë të interest të përgjithshëm.

**Neni 9**

**Taksa për dhënien me qira të objekteve në pronësi të KK.Rahovec (Ankand publik)**

| Nr. | Emertimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Dhënia me qira të objekteve për banim, pushim dhe rekreacion-Taksë mujore. | 0,50 €/m² |

**Neni 10**

**Tarifat për Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**

**Taksa për shndërrimin e tokës bujqësore në tokën ndërtimore, dhënien me qira të Tokës bujqësore dhe dhënia e pëlqimeve, vlerësimeve dhe vërtetimeve..etj.**

*10.1 Taksa për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore*

| Nr | Emertimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Kategoria e tokës-klasa | Ndërrimi i përhershëm |
| 2 | I | 1.00€/m² |
| 3 | II | 1.00€/m² |

| | | |
|---|---|---|
| 4 | III | 1.00€/m² |
| 5 | IV | 1.00€/m² |
| 6 | V | 0.75€/m² |
| 7 | VI | 0.75€/m² |
| 8 | VII | 0.50€/² |
| 9 | VIII | 0.50 €/m² |

10.a- Sipas U.A.-41/2006 pika 14.4, ku thuhet për ndërrim të përkohshëm te destinimit duhet te paguhet kompenzimi 20% për m$^2$,sipas klasifikimit të përcaktuar ne paragrafin 2 të keti neni,perveq se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe .

**10.2 Tarifat minimale ( fillestare) për dhënie me qira të tokës bujqësore:**

**(Tokat jepen me qira permes ankandit publik)**

| Nr. | Emertimi i ri | Vlera pa ujitje | Vlera me ujitje |
|---|---|---|---|
| 1 | Kategoria e tokës/Klasa I-II | 3.5 €/ari -pa ujitje | 5.0 €/ari- me ujitje |
| 2 | Kategoria e tokës/Klasa III-IV | 3.0 €/ari-pa ujitje | 4.0 €/ari- me ujitje |
| 3 | Kategoria e tokës /Klasa V-VI | 2.0 €/ari-pa ujitje | 3.0 €/ari- me ujitje |
| | Kategoria e tokës/Klasa VII-VII | 1.0 €/ari-pa ujitje | 2.0 €/ari- me ujitje |

**10.3 Dhënia e pëlqimeve, vërtetimeve nga lëmi i bujqësisë**

| Nr | Emertimi | Vlera |
|---|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Vlerësim i dëmeve në bujqësi nga komisioni | 10,00 € |
| 2 | Dhënia e pëlqimit për shfytëzimin e tokave pyjore për qëllime bujqësore | 25,00 € |
| 3 | Dhënia e vërtetimit për shitjen e prodhimeve bujqësore vetanake | 2,00 € |
| 4 | Vërtetimi për dëshmi që është prodhues bujqësor | 2,00 € |
| 5 | Parashtrimi i kërkesës drejtorisë për bujqësi | 1,00 € |
| 6 | Parashtrimi i ankesave nga palët | 2,00 € |
| 7 | Dhënia e pëlqimit për nevoja industriale(gurëthyes ,etj). | 100.00€ |
| 8 | Lëshimi i Certifikatës së Regjistrimit të Fermerit (NIF) | 1.00 € |

## Neni 11

## Tarifat për Drejtorinë për Punët Inspektuese

***Taksat për shërbimet inspektuese***

| Nr | Emertimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Kërkesa për kontroll inspektues për persona fizik | 10.00 € |
| 2 | Kërkesa për kontroll inspektues për subjekte afariste | 20.00 € |
| 3 | Kërkesa për pëlqim pune | 15,00 € |
| 4 | Kërkesa për asgjësim mallrash | 15,00 € |
| 5 | Kërkesa për daljen në terren për PTK-në, KED S-in | 100.00 € |
| 6 | Kërkesa për daljen në terren për: KRU Radoniqi, Ambienti | 50.00€ |
| 7 | Kontroll të therrjeve të gjedheve( inspektor veterinar) në therrtore të licencuara nga AUV për krerë | 5.00 € |

**Taksat e kësaj drejtorie janë të përcaktuara me anë të Udhëzimit Administrativ 05/2012 për tarifat e shërbimeve dhe të produkteve kadastrale të ofruara nga ZKK(zyrat komunale kadastrave) dhe kompanitë gjeodete të licencuara, dhe Udhëzimit Administrativ 08/2014 për tarifat e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme.*

*Dy udhëzimet Administrative janë unike dhe zbatohen nga të gjitha zyra komunale kadastrale, në tërë territorin e Republikës së Kosovës.*

**Neni 12**
**Taksat për shërbimet kadastrale**

**12.1 Ndërrimi i kulturave të parcelave**

| Nr. | Emërtimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Ndërrimi i kulturës të një parcelë pa matje gjeodezike | **10,00 €** |

**12.2. Ndarja e parcelave**

| **Nr.** | **Emërtimi** | **Vlera** |
|---|---|---|
| 1 | Ndarja e një parcele në dy pjesë sipas gjendjes faktike në terren deri në 0,50 ha | **75,00 €** |
| 2 | Për çdo ndarje në pjesë tjetër | **25,00 €** |
| 3 | Ndarja e një parcele në dy pjesë sipas gjendjes faktike në terren në sipërfaqe 0.50ha-1 ha | **100,00 €** |
| 4 | Ndarja e një parcele në dy pjesë sipas gjendjes faktike në terren në sipërfaqe 1ha - 5ha | **150,00 €** |
| 5 | Ndarja e parcelës në pjesë të përcaktuara më parë | **80,00 €** |
| 6 | Ndarja në më tepër se dy pjesë të përcaktuara më parë për çdo pjesë | **40,00 €** |
| 7 | Ndarja e komplekseve me sipërfaqe prej 5-10 ha ne dy pjesë | **200,00 €** |
| 8 | Për çdo ndarje në pjesë tjetër | **100,00 €** |
| 9 | Ndarja e komplekseve me sipërfaqe mbi 10 ha në dy pjesë | **500,00 €** |
| 10 | Për çdo ndarje në pjesë tjetër | **200,00 €** |

**12.3. Bashkimi i parcelave**

| Nr. | Emërtimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Bashkimi i dy (2) parcelave pa matje | **20,00€** |
| 2 | Për çdo parcelë tjetër në kufi | **10,00€** |

**12.4. Matjet e ndërtesave**

| **Nr.** | **Emërtimi** | **Vlera** |
|---|---|---|
| 1 | Matja për një ndërtesë individuale për 1m² të bazës gjeodezike | **0,50€** |

| | | |
|---|---|---|
| 2 | Për çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për $1m^2$ të bazës gjeodezike | 0,25€ |
| 3 | Ndërtesë banimi kolektiv për $1m^2$ | 0,50€ |
| 4 | Për çdo ndërtese tjetër në të njëjtën parcelë për $1m^2$ | 0,50€ |
| 5 | Ndërtesë afariste për $1m^2$ | 0,70€ |
| 6 | Për çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për $1m^2$ | 0,70€ |
| 7 | Ndërtesa banesore-afariste për $1m^2$ | 0,70€ |
| 8 | Për çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për $1m^2$ | 0,50€ |
| 9 | Ndërtesë e administratës qeveritare dhe publike për $1m^2$ | 0,50€ |
| 10 | Për çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për $1m^2$ | 0,50€ |
| 11 | Objektet për sport dhe rekreacion për $1m^2$ | 0,50€ |
| 12 | Objekte kulturore dhe fetare për $1m^2$ | 0,30€ |
| 13 | Për çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për $1m^2$ | 0,50€ |

**12.5. Matjet e pjesëve të ndërtesave**

| Nr. | Emërtimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Hapësira banesore dhe përpilimi i skicës së katit të ndërtesës për $1m^2$ | 0,80€ |
| 2 | Kati me skicat e njësive të veçanta për $1m^2$ | 0,70€ |
| 3 | Hapësira afariste dhe përpilimi i skicës për $1m^2$ | 1,00€ |
| 4 | Ndarja e hapësirave banesore dhe përpilimi i skicës – për çdo pjesë - për $1m^2$ | 0,75€ |
| 5 | Ndarja e hapësirave afariste dhe përpilimi i skicës – për çdo pjesë - për $1m^2$ | 0,75€ |

**12.6. Matjet e përçojave**

| Nr. | Emërtimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Përçoja nëntokësore për metër gjatësi | 0,50€ |
| 2 | Përçoja mbi tokësore për metër gjatësi | 0,25€ |
| 3 | Objektet nëntokësore | 100,00€ |
| 4 | Për çdo objekt tjetër | 50,00€ |
| 5 | Tunelet për metër gjatësi | 5,00€ |

**12.7. Përcaktimi i kufijve të parcelave**

| Nr. | Emërtimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Për një parcelë me sipërfaqe deri në 0.50 ha | 80,00€ |
| 2 | Për parcelën (sipërfaqen) prej 0.50-1.00 ha | 100,00€ |
| 3 | Për çdo hektar tjetër mbi një(1) hektar | 60,00€ |

| | | |
|---|---|---|
| 4 | Për parcelat urbane sipas planit urbanistik (pas marrjes së pëlqimit prej Drejtorisë së Urbanizmit) | 120,00€ |

**12.8. Ri rregullimi i kufijve të parcelave**

| Nr. | Emërtimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Për një parcelë me sipërfaqe deri në 0.50 ha | 40,00 € |
| 2 | Për sipërfaqe prej 0.50-1.00 ha | 50,00 € |
| 3 | Për çdo hektar tjetër mbi një (1)hektar | 30,00 € |

**12.9. Dhënia e dëshmive nga baza e të dhënave kadastrale tekstuale apo grafike sipas kërkesës së palëve nga ZKK**

| Nr. | Emërtimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Dhënia e vërtetimeve të ndryshme | 3,00 € |
| 2 | Certifikata mbi pronën deri në 10 (dhjetë fletë A4) | 4,00 € |
| 3 | Kopja e planit për një parcelë | 5,00 € |
| 4 | Për çdo parcelë tjetër | 2,00 € |
| 5 | Kopja e hartës kadastrale A0. Letër e thjeshtë, horizontal (1:500, 1:1000, 1:2500, 1:5000) | 20,00 € |
| 6 | Historiati për një parcelë | 30,00 € |

**12.10. Punët e zyrës sipas kërkesës së palëve**

| Nr. | Emërtimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Identifikimi i njësive kadastrale (parcelës) në terren për njësi të kadastrave (parcelë) | 20,00€ |
| 2 | Për çdo njësi tjetër në kufi | 5,00€ |
| 3 | Kontrollimi dhe regjistrimi në regjistër i të dhënave nga terreni-për njësi kadastrale- | 20,00€ |

**12.11. Punët e veçanta gjeodezike**

| Nr. | Emërtimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Bartja në terren e të dhënave nga planet urbanistike për objekte individuale për 1m² | 0,50€ |
| 2 | Bartja në terren e të dhënave nga planet urbanistike për objekte banimi kolektiv apo afarist për 1m² | 0,50€ |

**12.12. Baza gjeodezike (përshkrimi i pikave)**

| Nr. | Emërtimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Pikat trigonometrike: | |
| a | Koordinatat y,x me përshkrim | 5,00€ |
| 2 | Pikat lidhëse: | |
| a | Koordinatat y,x me përshkrim | 4,00€ |
| 3 | Pikat poligonale: | |
| a | Koordinatat y,x,z me përshkrim | 3,00€ |
| 4 | Pikë reper: | |
| a | Koordinatat y,x,z me përshkrim | 5,00€ |
| 5 | Pikat në linjë: | |
| a | Koordinatat y,x,z | 2,00€ |
| 6 | Pikat e detajit: | |
| a | Koordinatat y,x | 1,00€ |
| 7 | Vendosja e pikave trigonometrike | 50,00€ |

**Neni 13**

**Taksat për regjistrim të pronësisë, posedimit, hipotekave, servituteve, qira mbajtës dhe përçuesve**

**13.1 Taksat për regjistrimin e pronësisë dhe posedimit**

**13.1.1 Taksat për regjistrim të pronësisë dhe posedimit në bazë të transaksioneve [shitblerjes]**

| Nr. | Emërtimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Për vlerën e transaksionit deri në 10.000,oo € | 20,00€ |
| 2 | Për vlerën e transaksionit nga 10.000,oo deri 30.000,oo € | 30,00€ |
| 3 | Për vlerën e transaksionit nga 30.000,oo deri 50.000,oo € | 35,00€ |
| 4 | Për vlerën e transaksionit nga 50.000,oo € deri 100.000 | 50,00€ |
